



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.40/2018
Prishtinë, më 18.9.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari-Lila, Liburn Aliu, Muharrem Nitaj dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Sala Berisha Shala, kryetare, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Memli Krasniqi, Glauk Konjufca dhe Duda Balje, anëtarë.

Të ftuar: Arsim Janova, u.d. i kryesuesit të Bordit të ZRRE-së;
Rashit Gashi, Federata e Sindikatave të Pavarura “ElektroKosova” (FSPE).

Pjesëmarrës: Selman Hoti, Petrit Pepaj, Imer Fejzullahu dhe Adelina Bajrami, ZRRE; Fehmi Pajaziti, FSPE; Verona Bekteshi, KDI; Dren Ajeti, Klubi i Prodhuesve Kosovarë; Mehmet Krasniqi, “Ekonomia Online”; Burbuqe Ibishi, “Kosovapress”; Arta Berisha dhe Vatra Qehaja, GP LV; Shpresë Sejdiu, PSD.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, Veton Raci dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 11.9.2018;
3. Diskutim lidhur me raportet konsultative për përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale, si dhe raportin konsultativ për përcaktimin e faktorit të efikasitetit, të ftuar: Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe Federata e Sindikatave të Pavarura “ElektroKosova” (FSPE).
4. Shqyrtimi i Planit të punës së komisionit për sesionin vjeshtor 2018;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

Kryesuesi, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë i komisionit, fillimisht i shprehu mirëseardhje anëtarit të ri të këtij komisioni, z. Veton Berisha nga Grupi Parlamentar NISMA.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi propozoi që pika e katërt të kalojë si pikë e tretë e rendit të ditës, pasi që do të merret një vendim, sepse disa deputetë do të largohen më herët, për shkak të angazhimeve tjera.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga kryesuesi.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.9.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 19.9.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Planit të punës së komisionit për sesionin vjeshtor 2018

Dardan Sejdiu, theksoi se sipas vendimit të komisionit, deri të premtën e kaluar, nuk ka dhënë dikush ndonjë propozim shtesë për plan të punës dhe kërkoi që i njëjti të miratohet.

Hykmete Bajrami, propozoi që në plan të punës të përfshihet edhe raportimi i ministrit të Zhvillimit Rajonal dhe ministrit të Inovacionit, që të raportojnë lidhur me subvencionet që japin këto ministri.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet plani i punës së komisionit për sesionin vjeshtor 2018, me plotësimet e propozuara nga deputetja Hykmete Bajrami.

4. Diskutim lidhur me raportet konsultative për përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale, si dhe raportin konsultativ për përcaktimin e faktorit të efikasitetit, të ftuar: Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe Federata e Sindikatave të Pavarura “ElektroKosova” (FSPE)

Dardan Sejdiu, potencoi se kjo pikë përmban diskutim, lidhur me raportet konsultative për përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale, si dhe raportin konsultativ për përcaktimin e faktorit të efikasitetit, ku janë ftuar, Zyra e Rregullatorit për Energji dhe Federata e Sindikatave të Pavarura “ElektroKosova”, për të diskutuar lidhur me procesin e shqyrtimit tarifar, dhe në veçanti, faktorin e efikasitetit. Z. Sejdiu ia dha fjalën z. Arsim Janova, nga ZRRE, të bëjë një prezantim të shkurtër për ecurinë e procesit.

Arsim Janova (u.d. i kryesuesit të Bordit të ZRRE-së), tha se Zyra e Rregullatorit për Energji, në maj të vitit 2017, ka hapur procesin e shqyrtimit të periudhës së dytë rregullatore, për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) dhe Operatorin e Sistemit të

Shpërndarjes (KEDS), për periudhën rregullatore 2018 – 2022. Tani jemi në përmbyllje të procesit rregullator të periudhës së dytë rregullatore. Bazuar në procedura ligjore, në një proces transparent dhe pas konsultimeve publike me të licencuarit dhe palët e tjera të interesit, më datën 20 gusht 2018, bordi ka miratuar vlerat hyrëse për periudhën e dytë rregullatore për KOSTT-in dhe KEDS-in, siç janë: 1. Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit (MPKK); 2. Caku dhe lakorja e reduktimit të humbjeve; 3. Kategoritë dhe jetëgjatësia e aseteve. Mbi bazën e këtyre vlerave, departamenti përkatës për tarifa, ka përgatitur raportet konsultative për të hyrat e lejuara maksimale për KOSTT-in dhe KEDS-in. Procesi i konsultimeve ka përfunduar dhe pritet miratimi nga bordi, në mbledhjen e radhës, e cila do të mbahet në javën e ardhshme. Raporti konsultativ për të hyrat e lejuara maksimale për furnizuesin e shërbimit universal, për vitin relevant tarifar 2018, është në proces të konsultimeve publike. Meqenëse Departamenti për Tarifa dhe Çmime është në fazën e përmbjlljes së raporteve për të hyrat e lejuara maksimale, Ymer Fejzullahu, udhëheqës i Departamentit për Tarifa, do të t'iu informojë lidhur me procesin e të hyrave të lejuara maksimale për KOSTT-in dhe KEDS-in.

Ymer Fejzullahu (ZRRE), theksoi se i kemi përgatitur dy raporte konsultuese për të hyrat e lejuara maksimale për KOSTT-in dhe KEDS-in, pasi që kanë edhe monopol natyror dhe është obligim i ZRRE-së t'i caktojë të hyrat për këta dy operatorë të licencuar nga ZRRE-ja. Kemi pranuar komente prej KOSTT-it dhe KEDS-it, dhe po ashtu, kemi pranuar komente edhe prej Federatës së Sindikatave dhe Shoqatës për Mbrojtjen e Konsumatorit nga palët dhe i kemi trajtuar ato komente. Jemi në fazën e përgatitjes së përgjigjeve finale dhe besojmë se më 24 shtator do t'i dorëzojmë për miratim në bord. Në qoftë se ka ndonjë argument të bazuar në fakte, ne si staf teknik do t'i marrim parasysh.

Hykmete Bajrami, theksoi se neve na intereson se si ndryshojnë tarifat nga periudha e kaluar. - Cilat janë ato që janë ngritur dhe cilat ato që janë zbritur? Sa është norma e interesit që ju ia keni pranuar KEDS-it? Sa janë humbjet, shpenzimet operative që ju ia keni pranuar? Pranimi i humbjeve 1.9%, si justifikohet nga ana e juaj? Gjithashtu, edhe të na tregoni faktorin e efikasitetit, me të cilin janë të shqetësuar edhe përfaqësuesit e sindikatave që janë këtu. Na tregoni që propozimi i juaj ka qenë ky dhe a ka ndryshuar me marrjen parasysh të ndonjë komentit? Po ashtu, të na tregoni indikatorët që do të ndikojnë te punëtorët edhe te konsumatorët.

Dardan Sejdiu, ua rikujtoi përfaqësuesëve të ZRRE-së mbledhjen e prillit 2018, ku ishte thënë se kredia afatgjate në Kosovë ka rënë dukshëm dhe nuk duhet të pranohet kostoja e kapitalit, e cila është prezantuar nga KEDS-i. Ne u kemi rekomanduar që t'i referoheni normave të tregut të Kosovës. Në raportin e BQK-së për vitin 2017, thuhet se norma e interesit në kredi është zvogëluar në 6.5% nga 6.8%, sa ishte në dhjetor të viti 2016. Kjo është për të gjithë tregun dhe i bie që norma e interesit për korporata për koston e kapitalit është hiç më shumë se 5%. Ai pyeti: Si është trajtuar rekomandimi i këtij komisioni, sa i përket koston së kapitalit? Më tutje, z. Sejdiu duke iu referuar takimit të prillit 2018, theksoi se te efikasiteti, siç e cekët, tre vite nuk keni pasur faktor të efikasitetit, sepse me kontratë KEDS-i ka qenë i obliguar të mbajë numrin e punëtorëve, pra efikasitetin e keni lidhur drejtpërdrejt me punëtorë dhe kjo është brengosëse. Ai shtoi se edhe humbjet që kanë qenë pjesë e kontratës, kur është privatizuar KEDS-i, parametrat e paraparë të realizimit të reduktimit të humbjeve nuk janë arritur. Në fund, pyeti: Me çfarë kostoje të kapitalit e keni pranuar, sepse kjo është vlerë hyrëse e rëndësishme për investime?

Efikasiteti nuk ka kuptim të ndërlidhet vetëm me punëtorë. Numri i konsumatorëve, në vitin 2013, ka qenë 430 mijë, ndërsa sot 560 mijë, pra është rritur edhe tregu. Cili është kuptimi që kur rritet tregu, të reduktohen shpenzimet ose të reduktohen punëtorët? Na tregoni vlerat e lejuara për humbjet, a janë në përputhje me kontratën e nënshkruar apo janë larg asaj?

Ymer Fejzullahu (ZRRE), theksoi se ne e kemi obligim ligjor që t'i referohemi tregut të Kosovës dhe tregut rajonal. Kostoja e kapitalit, e miratuar më 20 gusht, ka qenë 8.3, nëse norma e borxhit është 7.2. Në takimin e kaluar, e kemi thënë se norma mesatare për periudhën e ardhshme pritet të jetë 6.5, duke iu referuar "normës Paris", të emituar nga letrat me vlerë nga Ministria e Financave. Norma e kuponit, herën e kaluar, ka qenë 3% (norma Paris), si mesatare e bonove të emetuar nga Ministria e Financave, ndërsa në propozimin final, ne kemi marrë parasysh edhe vlerën e fundit të emetuar nga Ministria e Financave, që ka rezultuar me normën e kuponit me 5.2%. Kjo ka rezultuar që mesatarja e ponderuar e këtyre kuponëve të jetë 3.7. Domosdoshmërisht, kostoja e borxhit është reflektuar nga 6.5 në 7.2, dhe rrjedhimisht, mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit në 8.3. Kjo është norma e vendosur në gusht të vitit 2018. Sa i përket faktorit të efikasitetit, duke pasur në konsideratë se është i licencuar, bordi i kaluar ka marrë vendim që faktori i efikasitetit për periudhën fillestare të jetë zero. Edhe faktori i efikasitetit është vetëm njëri prej parametrave. Ne mendojmë që ndërmarrjet tona kanë hapësirë që ende t'i zvogëlojnë shpenzimet operative, por jo domosdoshmërisht t'i zvogëlojnë shpenzimet operative, që lidhen me punëtorë. Në këtë periudhë të dytë rregullatore, i kemi rritur edhe investimet kapitale të lejuara që janë rreth 130 milionë euro për pesë vjetët e ardhshme. Sa i përket humbjeve 1.9, ka qenë një target i vendosur nga bordi i kaluar, ku atë cak nuk ka mundur të arriete KEK-u, në vitin 2012, si bartës i licencës dhe kjo barrë është bartur nga operatori i ri. Ka qenë një vendim për gjashtë vite dhe ai vendim ka skaduar në prill të këtij viti. Ndërsa, tani Bordi i ZRRE-së e ka konsideruar si të arsyeshëm, një barrë që operatori privat e ka bartur për pesë vite, është bërë një rivlerësim i mesatares së humbjeve të OSSH-ve në rajon dhe kjo iu është njohur si kosto e arsyeshme, sepse është një target i paarrtshëm. Targeti i ri i vendosur nga Bordi i ZRRE-së, i humbjeve të KEDS-it, është 18.8%, ndërsa humbjet aktuale të KEDS-it janë 24%.

Arsim Janova (ZRRE), theksoi se mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit ka qenë 12 për pesë vite, ndërsa tash është 8.3. Kërkesa e tyre ka qenë 13. Sa i përket humbjeve, kërkesa e vazhdueshme e KEDS-it ka qenë që 1.9% e humbjeve i janë transferuar pa të drejtë. Kryesuesi i mëparshëm i Bordit të ZRRE-së i ka dërguar shkresë KEDS-it, që kërkesa e juaj do të shqyrtohet në procesin e ardhshëm rregullator, pas përfundimit të periudhës së parë rregullatore. Është fakt që caku ka qenë 16.9 %, që të arrihet deri më 2017, ata kanë arritur në 24%. Janë bërë shumë analiza dhe kemi ardhur në përfundim që t'i pranohet kjo humbje, megjithatë prej 24% deri te 18.8%, është një diferencë rreth 5% e humbjeve, e cila mbulohet nga vetë operatori.

Dardan Sejdiu, potencoi se ai është dashur të arrihet në 16.9%, humbjet deri në 2017, e tash bordi ia zvogëlon cakun që është dashur të arrihet deri më 2017. E në anën tjetër, KEDS-i pretendon se kostoja e kapitalit duhet të jetë 13%, e ju ia keni pranuar 8.3, pra nuk mendoj që është në rregull. Qasjen duhet pasur tjetër. Mesatarja e kredive, sipas raportit të BQK-së, është 6.5%, dhe për krahasim, ZRRE-ja po e merr sa kushton paraja, kur i kërkon një shtet, e jo një korporatë. Duhet të krijohet një balancë, e jo të merret një numër, kur ka marrë shteti kredi e të reflektohet ai numër. Kjo nuk është vlerë, ku duhet të referoheni.

Ymer Fejzullahu, sqaroi se në periudhën e kaluar pesëvjeçare, rregullatori ka lejuar 107 milionë euro investime për operatorin e sistemit të shpërndarjes. Në këtë rast, për KEDS-in, ndërsa ka realizuar 100 milionë euro. Kjo diferencë do t'iu kthehet me normë të interesit konsumatorëve. Në periudhën e dytë, kërkesa e KEDS-it ka qenë 153 milionë euro, ndërsa propozimet e ZRRE-së 130 milionë euro. Kjo ka rezultuar në të hyra të lejuara maksimale, 80 milionë euro në vit. Sa i përket efikasitetit, teknologjia e re ka ndikim edhe në reduktimin e kostove operative, pa specifikuar a është personel, mirëmbajtje apo ndonjë kategori tjetër. Edhe si referencë e kemi marrë 1.5%, në raport me 4%, sa ka qenë në periudhën e kaluar për KEK-un edhe për KOSTT-in, dhe tani për KEK-un, nuk kemi faktor të efikasitetit, sepse nuk e rregullojmë.

Hykmete Bajrami, pyeti: A ka faktor të efikasitetit edhe për KOSTT-in? A mund të na garantoni se faktori i efikasitetit nuk do të ndikojë në largim të punëtorëve? Duhet ta ruani edhe interesin e punëtorëve, edhe të qytetarëve. Pranimi i humbjeve edhe për 1.9%, më shumë e papranueshme. Norma e interesit që keni pranuar është mbi mesatare. Unë kam marrë kredi me 4.9% interes.

Liburn Aliu, theksoi se brenga është se punëtorët do të largohen nga puna, për shkak të faktorit të efikasitetit. Do të largohen nga puna punëtorë me paga të larta dhe merren në punë punëtorë me paga të ulëta. Kërkojmë që të shqyrtohen forma tjera, ku të rritet efikasiteti i ndërmarrjes. Sa i përket normës së interesit, norma prej 8.3 e interesit është shumë e lartë.

Mimoza Kusari – Lila, theksoi se KEDS-in e kemi monopol natyror. Rrjedhimisht, ju, në periudhën e shqyrtimit tarifor, keni dëgjime dhe takime edhe me KEDS-in. Ajo që nuk më pëlqeu, kur filluat ta trajtoni faktorin e efikasitetit dhe kur filluat t'i trajtoni normat tjera të pranuar apo të diskutuara, qoftë prej shifrave të BQK-së ose të tjerëve, është që lejoni një fleksibilitet, në të cilin ju ia ofroni një mundësi KEDS-it, që në kuadër të faktorit të efikasitetit, KEDS-i mund të ketë shkurtime në teknologji, sepse kemi përparim të teknologjisë. I vetmi mekanizëm që mund të kemi për çfarëdo rregullimi brenda KEDS-it, jeni ju, si ZRRE. Në ato konsultime që ju i keni për tarifa, në këtë rast pesëvjeçare 1.5, nuk duhet pasur fleksibilitetin e diskutimit, të cilin ju e prezantoni, që mund të jetë edhe teknologji informative dhe krejt liria tjetër është e KEDS-it. Ne, si komision, nuk e kemi asnjë forcë që në rast se ata faktorin e efikasitetit e vendosin ta aplikojnë në resurse njerëzore, t'iu themi jo, sepse nuk bën në resurse njerëzore. Ju jeni i vetmi mekanizëm që mund t'i diskutoni deri në detaje. Unë ju apeloj që kjo duhet të jetë fokusi i juaj. Ju duhet të keni mekanizëm se ku duhet të aplikohet faktori i efikasitetit.

Rashit Gashi (FSPE), theksoi se fatkeqësisht 80% e shpenzimeve operative janë paga të punëtorëve dhe automatikisht faktori i efikasitetit ndikon te punëtorët. Faktori i efikasitetit 5% i periudhës së kaluar ka ndikuar direkt në numrin e punëtorëve. Me qindra punëtorë sot përballen nëpër gjykata dhe kemi mungesë të stafit. Për ne është shqetësuese, sepse ZRRE-ja merr për bazë inflacionin e eurozonës. Faktori i efikasitetit do të aplikohet në shpenzimet e personelit, për shkak se në pesë vitet e para, KEDS-i ka investuar kryesisht në automjete dhe tash ato automjete e kanë kaluar afatin e zhvlerësimit, sipas librave kontabël. Shpenzimet te mirëmbajtja shkojnë duke u rritur, prandaj faktori i efikasitetit do të ndikojë vetëm te shpenzimet e

personelit.

Arsim Janova (ZRRE), theksoi se nuk pajtohem me kualifikimin se po e favorizojmë kompaninë private e jo interesin publik. Pagat e punëtorëve nuk janë zbritur. Si rregullator, nuk futemi në mikromenaxhim të ndërmarrjes. Ne i kemi marrë në konsideratë shpenzimet për sigurime shëndetësore, kontratën kolektive, përvojën, shtesat për ushqim për punëtorë në kalkulimin e të hyrave të lejuara. Janë bërë shumë analiza dhe krahasime edhe me rajonin. Ne kemi ardhur këtu me një punë ekipore profesionale që kanë ekspertizë. Vetëm dy vite do të jetë e ngritur humbja 1.9%.

Fehmi Pajaziti (FSPE), theksoi se KEDS-i, kur është privatizuar, ka pasur 2623 punëtorë, ndërsa tash 2159 punëtorë, me 600 të larguar dhe 200 të punësuar tjerë. Faktori i efikasitetit ka ndikuar në largim të punëtorëve, prandaj edhe është brengë për neve. Nëse faktori i efikasitetit do të ndikojë diku tjetër e jo te punëtorët, atëherë për ne është në rregull.

Pas diskutimeve, komisioni nxori këto konkluzione:

- 1. Të rishikohen vlerat hyrëse dhe të merren në konsideratë rekomandimet e anëtarëve të komisionit nga mbledhja e 12 prillit 2018;*
- 2. Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit (WAAC), të jetë më e ulët dhe jo më e lartë se norma mesatare e kamatës, siç është në raportin e BQK-së;*
- 3. Të rishikohet faktori i efikasitetit, në mënyrë që mos të ndikojë në largimin e punëtorëve nga puna.*

5. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Zëvendëskryetar i parë i komisionit,

Dardan SEJDIU